

18.1 BURIMET E INTEGRUARA

Në burimet e integruara bëjnë pjesë:

- fletët e palidhura me përmbajtje të zëvendësueshme
- bazat e të dhënave
- faqet elektronike

18.1.1 Fletët e palidhura me përmbajtjeve të zëvendësueshme

Te këto burime përditësimet integrohen në tërësinë, ndërsa përmbajtjet e anuluar largohen.

Njësia bazë (p.sh. dosja), në të cilën i integroni shtojcat dhe përditësimet, inventarizohet në një fushë të re 997. Në redaktuesin **Fusha 996/997** në skedën **e,g,h,i,s,w,4,5** tek "Burimi i integruar (g\I)" përzgjidhni vlerën *m – njësia bazë (dosje, pako etj.)*; *shfaqja e kopjes në COBISS+*.

Tek fusha 997 për njësinë bazë vendosni edhe shënimin në nënfushën 997r, p.sh.: *përditësimet janë integruar*.

Shtojcat dhe përditësimet, të cilat nuk mbeten të ndara, mirëpo shkrihen në tërësinë e burimit të integruara (p.sh. në dosje), inventarizohen në një fushë të re 997 në kuadër të një viti kalendarik. Në nënfushën 997m shënoni numërtimin e përditësimeve ose shtojcave, të cilat i pranoni në vitin e njëjtë kalendarik. Në fushën 997 vendosni shenjën e burimit të integruar në këtë mënyrë: në redaktuesin **Fusha 996/997** në skedën **e,g,h,i,s,w,4,5** tek "Burimi i integruara (g\I)" përzgjidhni vlerën *i – shtojcë, përditësim, pjesë etj., e integruar në njësinë kryesore; nuk shfaqet në COBISS+*. Fushat e përzgjedhura:

- nuk shfaqen në COBISS+ dhe në katalogun për huazim
- nuk janë të disponueshme për rezervim ose huazim;
- janë të larguara nga inventari;
- respektohen në statistikën e rritjes, largimit dhe koleksioneve të bibliotekës (si në aspektin e numrit ashtu edhe në atë financiar).

Tek fushat 997 për shtojcat dhe përditësimet vendosni edhe shënimin në nënfushën 997r, npr.: *integruar në IN=<numri_i_inventarit_dosja>*.

Tek *përditësimet në CD* biblioteka (përkohësisht) mund të ruaj publikimet e mëparshme. Me shenjën e duhur të burimit të integruar, të cilën e vendosni në redaktuesin **Fusha 996/997** në skedarin **e,g,h,i,s,w,4,5**, tek "Burimi i integruar (g\I)" mund të përcaktoni mënyrën e paraqitjes në COBISS+:

- nëse nuk dëshironi të shfaqni të dhënat për kopjen përzgjidhni vlerën *i – shtojcë, përditësim, pjesë etj., e integruar në njësinë kryesore; nuk shfaqet në COBISS+*

- nëse dëshironi të shfaqni të dhënat për kopjet e vendosura në nënfushën 997m përzgjidhni vlerën *s – njësia kryesore (CD-ROM etj.)*; shfaqja e kopjeve në COBISS+.

18.1.1.1 Fletët e palidhura me përmbajtje të zëvendësueshme – kopja arkivore

Kopja arkivore duhet të ruaj formën origjinale. Përditësimet vetëm shtohen, ndërsa përmbajtjet e anuluar largohen.

Njësia bazë (p.sh. dosjen) e inventarizoni në fushën 997. Në nënfushën 997m vendosni edhe përditësimet, të cilat i pranoni në të njëjtin vit kalendarik që keni inventarizuar njësia bazë.

Shtojcat dhe përditësimet, të cilat vetëm i shtoni, inventarizohen në një fushë të re 997 në kuadër të një viti kalendarik. Në nënfushën 997m vendosni numërtimin e përditësimeve apo shtojcave, të cilat i pranoni në vitin e njëjtë kalendarik.

Kopjet arkivore nuk janë të disponueshme për huazim. Në fushat 997 nuk vendoset shenja e burimit të integruar.

18.1.2 Baza e të dhënave

Bëhet fjalë për bazat e të dhënave të disponueshme në mjedis fizik (p.sh. CD-ROM) ose në internet (me ose pa fjalëkalim), përmbajtja e të cilave përditësohet ose ndryshon.

18.1.2.1 Baza e të dhënave në mjedis fizik (p.sh. CD-ROM)

Njësia bazë inventarizohet në një fushë të re 997.

Përditësimet inventarizohen në një fushë të re 997 në kuadër të një viti kalendarik. Në nënfushën 997m vendoset numërtimi i përditësimeve, të cilat i pranoni në të njëjtin vit kalendarik.

Biblioteka vendos nëse botimin e mëparshëm do ta ruaj (përkohësisht) ose jo. Përmes shenjës së duhur të burimit të integruar, të cilën e vendosni në redaktuesin **Fusha 996/997** në skedën **e,g,h,i,s,w,4,5**, tek "Burimi i integruar (g\I)" mund të përcaktoni mënyrën e shfaqjes në COBISS+:

- nëse dëshironi të shfaqni të dhënat për kopjen përzgjidhni vlerën *i – shtojcë, përditësim, pjesë etj., e integruar në njësia kryesore; nuk shfaqet në COBISS+*
- nëse dëshironi të shfaqni të dhënat për kopjet e vendosura në nënfushën 997m përzgjidhni vlerën *s – njësia kryesore (CD-ROM etj.)*; shfaqja e kopjeve në COBISS+.

18.1.2.2 Baza e të dhënave në mjedisin fizik (p.sh. CD-ROM) – kopja arkivore

Kopja arkivore duhet të ruaj formën origjinale. Ruhen të gjitha botimet e mëparshme.

Kopjet arkivore nuk janë të disponueshme për huazim. Në fushat 997 nuk vendoset shenja e burimit të integruar.

18.1.2.3 Baza e të dhënave në internet

Informacionet për disponueshmërinë dhe qasjen janë të vendosura në fushën 856 në regjistrimin bibliografik. Nuk parashikohet vendosja e të dhënave për koleksionet në fushën 997. Të dhënat për pasurimin vendosen në modulën COBISS3/Burimet elektronike.

18.1.3 Faqet elektronike

Bëhet fjalë për faqet elektronike përmbajtja e të cilave përditësohet apo ndryshohet dhe është e disponueshme përmes internetit me ose pa fjalëkalim. Informacionet për disponueshmërinë dhe qasjen janë të vendosura në fushën 856 në regjistrimin bibliografik. Nuk parashikohet vendosja e të dhënave për koleksionet në fushën 997.